

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Përfaqësuesi për Lirin e Mediave
Harlem Désir

KONFERENCA E OSBE-SË PËR MEDIA NË EVROPËN JUGLINDORE KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konferenca e OSBE-së për Media në Evropën Juglindore, që u mbajt më 10-11 maj 2018, solli së bashku më shumë se 150 pjesëmarrës në Strugë, në bregun e Liqenit të Ohrit, përfshi përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile, shtypit dhe shoqatave mediale, sindikatave të gazetarëve, të transmetuesve publikë dhe profesionistë mediatik për të diskutuar çështjet e lirisë së medias në rajon. Konferenca e pestë që -pasoi pas Konferencës së organizuar nga Kryesia e OSBE-së “Liria e medias në Ballkanin perëndimor” në shkurt të vitit 2017, theksoi përvojat e shumta personale dhe profesionale të pjesëmarrësve mbi sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve, veçanërisht gazetarëve femra, si dhe kushtet e pasigurta gjatë punës me të cilat ballafaqohen punonjësit mediatik në rajon. Veç kësaj, konferenca gjithashtu trajtoi çështje tjera duke filluar nga transmetuesit publikë, për të cilët pjesëmarrësit kërkuan pavarësinë e tyre të përforcuar dhe qëndrueshmërinë e tyre financiare, deri në praktikën më të mira në sferën e vetë rregullimit medial, mundësive të reja ekonomike dhe sfidave, ndikimi i digjitalizimit lidhur me lirinë e medias, si dhe fenomenin e “lajmeve të rreme”, propagandën dhe dezinformimin.

Në ditën e parë të konferencës, pjesëmarrësit miratuan një deklaratë me të cilën dënuan dhunën kundër Olivera Lakiçit, gazetar hulumtues për gazetën Vjesti në Mal të Zi, e cila u qëllua mbrëmjen e 8 majit të vitit 2018. Tekstin i plotë të Deklaratës mund ta gjeni këtu:

<https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/380689>.

Deklarata përcolli një mesazh të fuqishëm të mbështetjes dhe solidaritetit për gazetaren, për punonjësit e gazetës Vjesti, si dhe për të gjithë gazetarët dhe punonjësit mediatik në rajon të cilët përballen me kërcënime, sulme dhe frikësim. Siguria e gazetarëve akoma mbetet një nga sfidat më të mëdha në rajon, dhe pjesa më e madhe e krimeve ndaj gazetarëve dhe mediave mbeten të pa ndëshkuara. Në Deklaratë, pjesëmarrësit bënë thirrje për një hetim të pavarur, efektiv dhe të shpejtë, si dhe autorët e sulmit, përfshi organizatorët e të njëjtit, të sillen para drejtësisë. Në vazhdim, u theksua se çdo sulm ndaj një gazetari jo vetëm që shkel të drejtat e gazetarit në fjalë, por gjithashtu minon “të drejtën e publikut për t’u informuar”, sundimin e ligjit, si dhe vetë demokracinë.

Pas gjashtë seancave mbi temat e theksuara më lartë, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave bëri prezantimin e të dhënave, konkluzioneve dhe rekomandimeve gjithëpërfshirëse nga Konferenca dyditore. Këto rekomandime janë hartuar në mënyrë që të mund të zbatohen nga të gjitha palët e interesuara në komunitetin medial dhe më gjerë, përfshi **politikbërësit** rajonal dhe autoritetet në çdo nivel, akademikët, mediat, shoqëria qytetare, komuniteti ndërkombëtar me veprim në rajon, ndërmjetësit dhe rregullatorët, sindikatat dhe shoqatat e gazetarëve, si dhe vet gazetarët.

Seanca 1: Siguria e gazetarëve

Pjesëmarrësit në seancë këmbyen përvojat e tyre personale dhe profesionale lidhur me kërcënimet, frikësimet, sulmet e dhunshme dhe fushatat shpifëse në internet dhe jashtë tij, me të cilat janë përballur gjatë kryerjes së punës së tyre. Pjesëmarrësit gjithashtu diskutuan mbi rreziqet specifike me të cilat përballohen gazetaret femra, përfshi frikësimet, shqetësimet dhe kërcënimet, duke marrë parasysh se ato ndeshen me “barrën e dyfishtë” të të qenurit në shënjestër për gjininë e tyre dhe profesionin e tyre. Një nga sfidat më të mëdha të nënvizuara ishte mungesa e mekanizmave për t’i sjellë para drejtësisë autorët e krimeve ndaj gazetarëve për shkak të mungesës së veprimit ligjor joadekuat ose mosveprimit të organeve për zbatimin e drejtësisë dhe mosndëshkimit të gjerë të krimeve të tilla. Theksi kryesor u vu në nevojën për kornizë adekuate ligjore për mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve, si dhe në rëndësinë e mjeteve juridike në rast të krimit, dhe në obligimin e autoriteteve për të siguruar përgjegjësi dhe luftë kundër mosndëshkimit. Në pjesë të caktuara të rajonit, edhe pse ekziston legjislacioni adekuat, mungon zbatimi i të njëjtit, i cili duhet të përforcohet.

Rekomandime:

- Në solidaritet me viktimat, dënim publik dhe pa mëdyshje të të gjitha sulmeve, frikësimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve, të cilat ngërthejnë, por nuk janë të limituara në: fushata shpifëse, vëzhgim, frikësim, mbyllje të zyrave me dhunë, shqetësim nëpërmjet internetit, vrasje, torturë, dhunë fizike;
- Angazhim me të gjitha palët relevante – respektivisht autoritetet shtetërore, pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, shoqëritë civile në vend dhe rajon, shoqatat e gazetarëve dhe mediat – për të mbështetur hetimet dhe përpjekjet për t’i sjellë autorët para drejtësisë, duke vazhduar me ngritjen e vetëdijes lidhur me kërcënimin ndaj demokracisë nga sulmet kundër gazetarëve, dhe rëndësinë e mbrojtjes së sigurisë së gazetarëve;
- Identifikim të lidhjes ndërmjet lirisë së mediave, drejtësisë dhe sundimit të ligjit për të reflektuar mbi nevojat e veçanta të komunitetit medial në aspekt të legjislacionit relevant, aktivitetet e prokurorisë dhe mekanizmave mbrojtës, përfshi mbrojtjen policore sipas nevojës; kjo gjithashtu kërkon resurse adekuate njerëzore dhe financiare për proceset hetimore dhe të prokurorisë, si dhe vullnet politik;
- Vazhdim i thirrjeve dhe zbatim i hetimeve të shpejta të sulmeve ndaj gazetarëve nga ana e organeve për zbatimin e ligjit, duke i marr ato kërcënime me shumë seriozitet pa marrë parasysh se a janë bërë me anë të internetit apo jo, si dhe ofrim i mekanizmave të përshtatshme për viktimat e kërcënimeve, shqetësimeve, dhunës apo frikësimit; për këtë do të nevojitet trajnim dhe bashkëpunim ndërmjet policisë dhe prokurorëve;
- Inkurajim i redaksive dhe sektorit medial për trajnim të profesionistëve mediatik për vetëmbrojtje nga shqetësimi, frikësimi dhe sulmet;
- Promovim i solidaritet të njëzëshëm në nivel lokal, nacional dhe rajonal për të dënuar sulmet, respektivisht në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar, autoritetet shtetërore, politikanët, shoqatat e gazetarëve dhe grupet përkatëse për përkrahje ;

- Njohje të barrës së dyfishtë me të cilën përballen gazetaret femra dhe përpilim i strategjisë për integrim gjinor për të siguruar sigurinë e tyre në internet dhe jashtë tij në mënyrën më të mirë.

Seanca 2: Kushtet për punë të gazetarëve dhe mediave

Ndonëse pjesëmarrësit ranë dakord se autoritetet kanë miratuar legjislacion në disa sfera për t'i përmirësuar kushtet për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, industria e mediave vazhdon të përballlet me sfida të konsiderueshme. Kushtet e pasigurta për punë lidhur me sigurinë sociale, pagat dhe kontratat të cilat në vazhdimësi krijojnë pasiguri në punë akoma mbizotërojnë. Së bashku me ndërhyrjen politike dhe/apo interesin afarist, kushtet për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik janë shpesh në nivel tepër të ulët. Për shkak të kushteve të pasigurta për punë dhe sfidave ekonomike me të cilat përballen mediat, pavarësia editoriale mund të minohet nga trysnia financiare dhe/apo politike.

Rekomandime:

- Ngritje e vetëdijes mbi kushtet e pasigurta për punën e punonjësve mediatik, siç mund të shihet nga pagat e ulëta, orët e çrregullta të punës, mungesës së sigurimit shëndetësor, sigurisë sociale, dhe përfitimeve të tjera nga puna. Vetëdija duhet të ngritet me qëllim të qartë për të përmirësuar kushtet për punë duke synuar mundësinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik që në mënyrë të pavarur të raportojnë mbi çdo shtypjeje politike apo ekonomike, dhe atë pa rrezik nga vetë-censura;
- Fuqizim, inkurajim dhe reformim i sindikatave, me veçanti ato për profesionistët mediatik dhe gazetarët për të fuqizuar marrëveshje kolektive për stafin permanent dhe atyre që punojnë në mënyrë të pavarur në internet dhe jashtë tij, duke promovuar një ndjenjë solidariteti ndërmjet atyre në këtë profesion për t'i rritur të drejtat sociale dhe të punës, siç janë siguria sociale, dobitë për të papunësuarit dhe sigurimi shëndetësor. Sindikatat duhet të njihen si përfaqësues legjitim të gazetarëve;
- Në mungesë të sindikatave të punëtorëve, nevojitet ndërmjetësim me autoritetet shtetërore relevante, siç janë inspektoratet e punës, për të siguruar se standardet nacionale shoqërore (kontratat e punës, orët e punës, pagesat për siguri sociale) respektohen dhe me atë fuqizohen standardet minimale shoqërore;
- Eksplorim i mundësive për kontrata kolektive në këtë profesion si mjet sigurie dhe garancie të sigurisë profesionale konstante të nevojitur për gazetari etike, ngjashëm si në profesionet tjera;
- Zhvillim dhe fuqizim i politikave dhe legjislacionit që mbron pluralizmin medial, duke mirëmbajtur konkurrencën pa ndërhyrje të paligjshme biznesi apo politike që mund të krijojë presion plotësues mbi politikën redaktuese të mediave dhe gazetarëve;
- Sigurim i transparencës në financimin dhe pavarësinë financiare të mediave si element kyç për të garantuar lirinë e tyre nga ndërhyrjet nga jashtë, në veçanti në rastet kur financat vijnë nga organet publike. Autoritetet nuk duhet të mundohen të kenë ndikim në tregun medial nëpërmjet subvencioneve të fshehta.

Seanca 3: Përforcimi i transmetuesve publik

Kjo seancë u fokusua në rolin e transmetuesve publikë dhe kornizat ligjore me të cilat rregullohet strukturat organizative dhe programet e tyre. Pjesëmarrësit diskutuan mbi rolin e këshillave drejtues dhe programatik dhe organizimin e tyre. Në veçanti, u diskutuan praktikrat më të mira që duhet të udhëheqin me udhëzimet editoriale, drejtimin strategjik dhe mandatin, si dhe nevojat e shoqërisë (gjuhësore, kulturore, politike). Pasi që përmbajtja e mundësuar nga transmetuesit publikë është kryesisht në interesin e shoqërisë, u konstatua se është e rëndësishme për ruajtjen e kredibilitetit dhe përmbushjen e mandatit kryesor të transmetuesve publikë dhe mu për atë shkak duhet të mbetet në domenin publik, duke pasqyruar përbërjen kulturore, etnike, sociale, gjuhësore dhe fetare të shoqërisë, si dhe të mirëmbajë interesin e publikut në çdo kohë. Për më shumë, pjesëmarrësit po ashtu diskutuan mbi nevojën për të nxitur më shumë raportime hetuese nga ana e transmetuesve publikë duke u fokusuar në çështjet në interes të shoqërisë duke ushtruar standarde profesionale dhe pavarësi editoriale.

Rekomandime:

- Sigurim se stafi, përfshi atë të Këshillave programatik dhe drejtues, është punësuar në bazë të meritave profesionale, dhe jo lojalitetit partiak, për të mirëmbajtur pavarësinë nga sfera politike dhe me konsideratë ndaj mandatit publik;
- Përpilim i modeleve individuale për financimin e transmetuesve publikë në pajtim me situatën reale dhe lokale, pasi që asnjë model i vetëm në kontekst rajonal nuk është kompatibil me tjetrin, dhe për ta siguruar qëndrueshmërinë financiare të tyre, duke kontribuar për pavarësinë politike të tyre.
- Konsideratë ndaj përbërjes kulturore, etnike, sociale, gjuhësore, fetare të shoqërisë për të siguruar se transmetuesit publikë pasqyrojnë të gjitha pikëpamjet e paraqitura në shoqëri në përputhje me mandatin e tyre të interesit publik;
- Inkurajim i reportazheve dhe gazetarisë hulumtuese edhe në transmetuesit publikë në pajtim me praktikrat më të mira;
- Nxitje të risive në transmetuesit publikë për të mbajtur audiencën, duke ofruar përmbajtje në internet dhe jashtë tij të përshtatur ndaj nevojave të shoqërisë, përfshi nëpërmjet metodave të programimit dhe transmetimit të informatave në internet (përfshi nëpërmjet teknologjive të reja siç janë aplikacionet, përmbajtja onlajn, mediat sociale) si dhe zgjerimin e rrjetit të të ardhurave të mundshme.

Seanca 4: Vet-rregullimi i mediave dhe përmirësimi i standardeve profesionale

Përfaqësues nga rajoni, në veçanti shoqatat e gazetarëve dhe grupet e interesit, prezantojnë praktikrat më të mira mbi vet-rregullimin, si dhe standardet profesionale në fushën e mediave. Paneli solli përfundimin se standardet etike të miratuara në bazë vullnetare ndërmjet shoqatave të gazetarëve ose brenda mediave specifike ju ndihmojnë punonjësve mediatik të raportojnë në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në rajon, është e vështirë që Këshillat e shtypit dhe mekanizmat e vet-rregullimit të realizojnë pavarësi dhe qëndrueshmëri financiare pa donacione ose financim publik, duke pasur parasysh se vet mediat luftojnë për të ardhura dhe nuk kanë mundësinë të

kontribuojnë për Këshillat e tillë. Por, paneli arriti në përfundim se nevojiten resurse të duhura financiare dhe njerëzore për mirëmbajtjen e pavarësisë editoriale dhe kredibilitetit gazetaresk.

Rekomandime:

- Ngritje e vetëdijes mbi mekanizmat vet-rregullues si mjet i vlefshëm në rajon për t'i përmbushur standardet profesionale dhe etike në një ambient të shumëllojtë medial, në bazë vullnetare. Duhet bërë përpjekje për zbatimin konsekuent të tyre;
- Përkrahje për hartimin e kodekseve të vet-rregullimit në frymë të gjithëpërfshirjes, transparencës, si dhe në interes të opinionit publik në përgjithësi, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira;
- Qëndrueshmëria e Këshillave të shtypit duhet të mbetet prioritet për komunitetin medial duke marr parasysh rolin e tyre thelbësor në lehtësimin e vet-rregullimit të mediave;
- Promovim i trajnimit, arsimimit, dhe ngritjes së vetëdijes brenda profesionit për të promovuar më tutje standarde profesionale dhe raportim të pavarur;
- Bashkëpunim me mekanizma hetimor të pavarur dhe mekanizma të vet-iniciativës siç janë Avokati i popullit, Këshillat e shtypit, Komisionet e pavarura, për të adresuar çështje lidhur me gazetarinë etike dhe profesionale;
- Strategjitë për edukim digjital janë të rëndësishme për të siguruar se gazetarët dhe aktorët medial si dhe opinionit publik mund të kyçen në mënyrë efikase në vet-rregullimin e mediave.

Seanca 5: Ndikimi i digjitalizimit mbi lirinë e shprehjes dhe mediave në rajon

Fokusi i këtij paneli ishte të diskutojë lidhur me ndikimin e digjitalizimit mbi mediat dhe lirinë e shprehjes, dhe në veçanti nëse i njëjti ka avancuar “demokratizimin” e spektrit mediatik duke ju ofruar qytetarëve treg për ta shprehur veten nëpërmjet internetit, ndërsa gazetarëve platformë ta përhapin raportimin e tyre akoma më gjerë. Panelistët arritën në përfundim se digjitalizimi gjithashtu sjellë edhe rreziqet e veta, pasi që tani konsumatorët mediatik ekspozohen ndajmë shumë informacioneve, të vërteta dhe po ashtu të rreme. Digjitalizimi e ka ndryshuar shtypin në mënyrë radikale, për më tepër dhe e ka zhdukur në disa vende. Seanca gjithashtu iu referua përgjegjësisë së portaleve të lajmeve të cilat gjerësisht shpërndajnë raportime , që ta konsiderojnë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në shpërndarjen e lajmeve cilësore.

Rekomandime:

- Kujdes, mbrojtje dhe respekt ndaj të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtave lidhur me lirinë e shprehjes dhe qasjes në informata në internet, njëjtë si dhe jashtë tij;
- Fokusim në kualitetin para kuantitetit të lajmeve dhe shpërndarjes së shpejtë në epokën e “demokratizimit” të mediave nëpërmjet teknologjisë;
- Duke konsideruar se kontrolli i fakteve duhet të paraqet bazë për tërë gazetarinë, duhet vazhduar me përforcimin e besueshmërisë së mediave nëpërmjet kontrollit të fakteve, veçanërisht në sferën e internetit;
- Asnjë model i vetëm për zgjerimin e bazës së të ardhurave në kohën digjitale nuk është afirmuar akoma. Për atë shkak, mediat duhet të eksplorojnë dhe eksperimentojnë me modele të ndryshme financimi;

- Zhvillimi i trajnimeve dhe promovimi i njohurisë në sferën e edukimit digjital, si dhe ngritja e vetëdijes mbi koston e krijimit të gazetarisë kualitative.

Seanca 6: “Lajmet e rreme” fenomen botëror dhe realitet rajonal

Përderisa termi “lajme të rreme” përdoret shpesh, paneli synonte të definojë, në aspekt akoma më konkret, se çka ngërthen ky term dhe si dezinformimi është përhapur më shumë se sa në të kaluarën. Pjesëmarrësit erdhën deri në përfundim se edhe pse ky fenomen ka ekzistuar gjithmonë, megjithatë është përkeqësuar nga përdorimi i internetit, që e ka bërë shpërndarjen e informatave të pa verifikuara dhe raportimin joprofesional akoma më të lehtë për përhapje. “Lajmet e rreme” nuk janë vetëm informata politike, të formuara në mënyrë strategjike me qëllim të minojnë shpërndarjen e sigurt të informatave të besueshme në sferën publike, por shpeshherë janë dhe të motivuara nga interesi i biznesit.

Rekomandime:

- Shtetet nuk duhet të miratojnë ndalesa legale për “lajmet e rreme”, lajmet e pavërteta ose terme të tjera të ngjashme të cilat janë kundër- produktive dhe mund të abuzohen;
- Ligjet ekzistuese, përfshi ligjet mbi shpifje civile, duhet të ofrojnë mekanizma juridik të përshtatshëm për shpërndarjen e informatave të pavërteta të cilat dëmtojnë reputacionin;
- Politikanët nuk duhet të bëjnë apo inkurajojnë deklarata të cilat e dinë se janë të pavërteta apo që paraqesin mosrespektim të pamatur për informata të verifikuara;
- Politikanët nuk duhet ta përdorin termin “lajme të rreme” për të sulmuar mediat apo gazetarët, pasi që kjo minon mirëbesimin në mediat dhe gazetarinë;
- Autoritetet dhe palët e interesuara duhet të synojnë krijimin e ambientit të komunikimi të lirë, të pavarur dhe të shumëllojshëm në shoqëri të edukuar lidhur me mediat si metoda më e mirë për kundërshtimin e përhapjes së informatave të pavërteta;
- Internet ndërmjetësit duhet patjetër të kenë politika të qarta kufizimin ose fshirjen e përmbajtjeve të cilat duhet të përmbushin në minimum, garanci për proces të rregullt dhe standarde ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes.